



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverballi i mbledhjes së 9-të të KPF-së të KK së Lipjanit mbajtur, më 28.10.2022, në sallën e kuvendit, me fillim në ora 14⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues
2. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, anëtare
3. Fitim Shala, anëtar
4. Albiona Tasholli, anëtare
5. Arsim Jashari, anëtar
6. Egzona Bytyqi, anëtare
7. Alban Salihu, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Shkelzen Hajdini, DSH
2. Imri Smetishti, DPUMM
3. Elmaze Behluli, DA
4. Visar Kozhani, DBF
5. Safet Krasniqi, auditor
6. Shemsi Azemi, Shef i tatimit në pronë

Procesverballin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha rendin e ditës e keni marrë me kohë, të cilën e lexoi në vazhdim.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 8-të e Kuvendit.
2. Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Shtator 2022.
3. Raporti i Përformancës së Komunës së Lipjanit për vitin 2021.
4. Propozim Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023.

5. Diskutimi i Planit të veprimit për adresim të rekomandimeve të ZKA.
6. Diskutimi i Raportit të Auditorit të brendshëm dhe planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve.
7. Propozim vendim për përcaktimin e formës, përmbajtjes dhe përdorimit të Flamurit të Komunës së Lipjanit.
8. Propozim Rregullore për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike.
9. Propozim Vendim për ndarjen mjeteve financiare për qendrën për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve-Strehimoren në mbrojtje të viktimave të dhunës familjare dhe atyre të dhunës gjinore.
10. Propozim Vendim për zëvendësimin anëtarit të komisionit vlerësues për shqyrtimin e dokumentacionit për vendosjen e bizneseve në Zonën Ekonomike “Parku Industrial” në Qylagë-faza e parë.

Pastaj Kryesuesi pyeti a ka vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës?

Pasi që nuk pati plotësime as vërejtje, kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja për punën e kësaj mbledhje me të gjitha votat, 7 për, aprovoi rendin e ditës:

Pastaj Kryesuesi tha se raportet a jeni që të kalojnë direkt në Kuvend?

Me të gjitha votat, 7 për, u aprovua propozimi që raportet (pikat 2,3,5,6)

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 8-të e KPF-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht me 7 vota për:

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 8-të të KPF-së

Shtesë: Ekstrakti

Pastaj u kalua në pikën e dytë të rendit të ditës

IV

Propozim Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Shemsi Azemi, shef i tatimit në pronë, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati, Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VII

Propozim vendim për përcaktimin e formës, përmbajtjes dhe përdorimit të Flamurit të Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Elmaze Behluli DA e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se kam një propozim që para komunës të vendoset edhe flamuri i UÇK-së. Kam një pyetje a ka pasur ndonjë komision lidhur me përzgjedhjen e flamurit?

Egzona Bytyqi, tha se a është obligative për institucionet që të mbajnë këtë flamur?

Daut Azemi, tha se nuk e di a ka pasur ndonjë komision, ndërsa me siguri që janë obligative institucionet ta mbajnë flamurin.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VIII

. Propozim Rregullore për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemit, ia dha fjalën Imri Semetishtit, drejtor i DPUMM-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Raporti

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që raporti t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

IX

Propozim Vendim për ndarjen mjeteve financiare për qendrën për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve-Strehimoren në mbrojtje të viktimave të dhunës familjare dhe atyre të dhunës gjinore.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Shkelzen Hajdini, drejtor i D.SH , i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se a është paraparë diqka në këtë edhe për dhunën ndaj gjinisë mashkullore?

Shkelzen Hajdini, tha se po është paraparë në këtë propozim për të dy gjinitë.

Egzona Bytyqi, tha se sa do të qëndrojnë këta persona ?

Sheklzen Hajdini, tha se zakonisht vizitat janë ditore.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

X

Propozim Vendim për zëvendësimin anëtarit të komisionit vlerësues për shqyrtimin e dokumentacionit për vendosjen e bizneseve në Zonën Ekonomike “Parku Industrial” në Qylagë-faza e parë.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 14:50

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit

Daut Azemi